



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Gramoz REÇI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2020**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) si autoriteti përgjegjës që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin dhe nga kushdo;

Duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit efektiv të organeve të barazisë dhe respektimit të standardeve për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, të parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

Duke vlerësuar rëndësinë e forcimit të mekanizmave institucionalë të barazisë në shoqëri dhe rolin e tyre për funksionimin e një shoqërie demokratike, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, pa diskriminim dhe intolerancë;

Duke mbështetur dhe nxitur bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera në nivel qendror e vendor, shoqërinë civile, medien dhe publikun,

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2020 në këto drejtime:

- Monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus të veçantë fëmijët në arsim, fëmijët me aftësi të veçanta, fëmijët romë dhe egjiptianë;

- Rritjen e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukuese për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi, mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje, nxitjen e respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përdorur mjetet e informimit publik;

- Rritjen e rekomandimeve të drejtuara institucioneve të administratës shtetërore, me qëllim trajtimin e barabartë dhe pa diskriminim të grupeve shoqërore;

- Angazhimin, propozimin e ndryshimeve në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, dhe pjesëmarrjen aktive të KMD-së në diskutimin në Kuvend të ndryshimeve, duke kontribuar në përmirësime thelbësore të ligjit dhe krijimin e një kuadri ligjor në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e institucioneve monitoruese në drejtim të mbrojtjes nga diskriminimi.

- Forcimin e bashkëpunimit me aktorët e shoqërisë civile që kontribuojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore;

- Rritjen e aktivitetit ndërgjegjësues të zyrave rajonale për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të hartojë një plan masash për njohjen dhe zbatimin sa më të mirë nga subjektet publike, private dhe shtetasit të risive në ligj, të miratuara në vitin 2020, si dhe për rritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe subjekteve private për parandalimin dhe luftimin e formave të reja të diskriminimit.

2. Të informojë në kohë Kuvendin e Shqipërisë, komisionet parlamentare përkatëse për zbatimin e rekomandimeve dhe rasteve kur KMD-ja nuk informohet për masat e marra nga subjektet për zbatimin e tyre.

3. Të rrisë angazhimin e tij në monitorimin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të komunitetit LGBTI në fusha të tilla si: aksesit në kujdesin shëndetësor, arsim, drejtësi, punësim, strehim, si dhe të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë për rekomandimet e adresuara dhe shkallën e zbatimit të tyre nga subjektet publike dhe private.

4. Të kontribuojë në raportin përfundimtar të Planit Kombëtar të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2016–2020, si një nga institucionet përgjegjëse për monitorimin e këtij plani.

5. Të shqyrtojë në kohë ankesat e adresuara dhe, nëse do të ketë çështje të mbartura nga viti i kaluar, të përfshijë në raportin vjetor arsyen e mbartjes së këtyre çështjeve.

6. Të realizojë vendimmarrje të bazuara në arsyetim të plotë të vendimeve, me qëllim kuptimin dhe zbatimin e drejtë të tyre nga subjektet. Raporti vjetor të përmbajë informacion për arsyet e shfuqizimit të vendimeve të KMD-së nga gjykatat.

7. Të vijojë të forcojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit dhe organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, me qëllim rritjen e efektivitetit të trajtimit të rasteve të diskriminimit dhe të krimeve me motive urretje dhe të përfshijë në raportin vjetor rezultatet konkrete nga Marrëveshja e Bashkëpunimit e nënshkruar me Avokatin e Popullit dhe nga bashkëpunimi me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

8. Të rrisë aktivitetin ndërgjegjësues përmes përdorimit të medias dhe formave të reja të komunikimit virtual, me qëllim nxitjen e respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe informimin për rolin e KMD-së sidomos në fushat më të përhapura të diskriminimit dhe për grupet më të diskriminuara. Një vëmendje të veçantë duhet t’u kushtojë veprimtarive ndërgjegjëse dhe informuese të shtetasve në zonat rurale dhe në bashkitë ku KMD-ja nuk ka zyra vendore.

9. Të publikojë statistika periodike për veprimtarinë e zyrave vendore të KMD-së dhe të informojë në mënyrë periodike Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për natyrën e problemeve të konstatuara në nivel vendor. Veprimtaritë e zyrave vendore të KMD-së dhe problemet e konstatuara të paraqiten si një rubrikë e veçantë në raportin vjetor.

10. Raporti vjetor të përmbajë kontributin e KMD-së në lidhje me konstatimet dhe rekomandimet në progresraportin e BE-së për Shqipërinë si dhe për ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat europiane në kuadër të procesit *screening*.

11. Në funksion të transparencës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të publikojë në faqen e tij zyrtare vendimet e formës së prerë, burimin e financimit, fondet dhe donacionet, të dhëna konkrete për përdorimin e fondeve të përfituara, vlerën e gjobave të vendosura dhe të derdhura në buxhetin e shtetit.

Miratuar në datën 3.6.2021